

LIGJI NR. 08/L-191**PËR EKSPERTËT GJYQËSOR**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR EKSPERTËT GJYQËSOR**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj përcakton kushtet dhe procedurën e licencimit të ekspertëve, subjektet që kryejnë ekspertizën, të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe mënyrën e angazhimit të tyre.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet nga ekspertët e licencuar, institucionet publike që kërkojnë ose pranojnë ekspertiza gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore apo administrative, si dhe nga institucionet që janë përgjegjëse për licencimin, mbikëqyrjen dhe disiplinimin e ekspertëve.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Për qëllime të këtij ligji, shprehjet e përdorura kanë kuptimin si në vijim:

- 1.1. Eksperti - personi i licencuar sipas këtij ligji për të ofruar shërbime të ekspertizës në fushën përkatëse;
- 1.2. Ekspertiza - vlerësim, analizë apo mendim i pavarur i një eksperti i bazuar në bazë të metodave shkencore dhe profesionale me qëllim të vërtetimit, vlerësimit ose sqarimit të argumenteve apo fakteve;
- 1.3. Super ekspertiza - ekspertizë e një shkalle më të lartë, e kryer në rastet kur dy apo më shumë ekspertiza kanë dallime esenciale, apo nëse konstatimi i tyre është kontradiktor, i paqartë ose jo i plotë;
- 1.4. Institucioni urdhërues - për qëllime të këtij ligji janë prokuroria dhe gjykata, vetëm për procedurë gjyqësore;
- 1.5. Institucioni kërkues - kategoritë e tjera të institucioneve të përcaktuara me ligj që kërkojnë dhe ju nevojiten ekspertizat;
- 1.6. Kandidat - personi fizik dhe personi juridik që aplikon për licencim;
- 1.7. Subjekti që kryen ekspertizën - personi fizik dhe juridik privat i licencuar për kryerjen e ekspertizës;

1.8. Institucionet publike te specializuara - institucione që ofrojnë ekspertiza sipas ligjit ose akteve tjera, duke përfshirë, por pa u kufizuar ne Institutin e Mjekësisë Ligjore, Institutin e Psikiatrisë Forenzike dhe Agjencinë e Kosovës për Forenzikë;

1.9. Institucionet publike profesionale - institucione që nuk janë të specializuara për ekspertim në bazë të ligjit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në institucionet e arsimit të lartë, institucionet shkencore dhe institucionet profesionale.

Neni 4 **Parimet e punës së ekspertit**

1. Eksperti punën e vet profesionale e mbështet mbi bazën e parimeve të:

- 1.1. ligjshmërisë;
- 1.2. pavarësisë;
- 1.3. profesionalizimit;
- 1.4. paanshmërisë;
- 1.5. efikasitetit; dhe
- 1.6. llogaridhënies.

KAPITULLI II **EKSPERTI DHE INSTITUCIONET E EKSPERTIMIT**

Neni 5 **Eksperti**

1. Eksperti është i pavarur dhe i paanshëm në kryerjen e ekspertizës brenda kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në vendimin për caktimin e ekspertit nga institucioni përkatës.

2. Eksperti është i obliguar që ekspertizën ta kryejë sipas legjislacionit përkatës, me ndërgjegje dhe shkallë të lartë të profesionalizimit, si dhe po ashtu, në pajtim me rregullat etike dhe standardet profesionale.

Neni 6 **Kryerja e ekspertizës**

1. Ekspertiza kryhet nga:

- 1.1. institucionet publike te specializuara;
- 1.2. institucionet publike profesionale; dhe
- 1.3. subjektet qe kryejnë ekspertiza.

Neni 7 **Institucionet publike te specializuara**

1. Institucionet publike te specializuara kanë përparësi ndaj ekspertëve të licencuar, institucionet përkatëse fillimisht drejtojnë kërkesën për ekspertiza tek institucionet e specializuara.

2. Personeli profesional i angazhuar në këto institucione nuk i nënshtrohet procesit për licencim si ekspertë sipas këtij ligji.

Neni 8 Institucionet publike profesionale

Institucionet publike profesionale mund të kryejnë ekspertiza apo super ekspertiza varësisht nga kërkesa apo urdhëri nga institucionet përkatëse.

Neni 9 Ekspertiza e huaj

1. Pavarësisht dispozitave të këtij ligji dhe në mungesë të ekspertëve brenda vendit, institucioni përkatës sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të palëve në procedurë mund të kërkojë ekspertizë apo super ekspertizë të huaj.

2. Për ofrimin e ekspertizës së huaj nga paragrafi 1 i këtij neni, eksperti apo institucioni përkatës duhet të ofrojë dëshmi që është i licencuar për ofrimin e ekspertizës përkatëse në shtetin e tij.

KAPITULLI III PROCEDURA E LICENCIMIT

Neni 10 Kushtet për licencim të ekspertëve

1. Procesit të licencimit për ekspert individual mund t'i nënshtrohen vetëm personat që përmbushin kushtet si në vijim:

- 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë diplomë universitare në fushën përkatëse;
- 1.3. të ketë njohuri profesionale dhe përvojë praktike në fushën që aplikon, si në vijim:
 - 1.3.1. të paktën pesë (5) vjet, pas përfundimit të studimeve master; apo
 - 1.3.2. të paktën shtatë (7) vjet, pas përfundimit të studimeve themelore.
- 1.4. të mos jetë i ndaluar në ushtrimin e profesionit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor;
- 1.5. të ketë licencën për ushtrimin e profesionit bazë sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
- 1.6. të ketë zotësi të plotë të veprimit;
- 1.7. të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë veprë penale në pesë (5) vitet e fundit, përjashtimisht për kryerjen e veprës penale nga pakujdesia dhe për të cilën është dënuar deri në një (1) vit burgim efektiv.

2. Përjashtimisht nën-paragrafëve 1.2. dhe 1.3. të paragrafit 1 të këtij neni, në ato raste kur nuk paraqiten mjaftueshëm kandidatë për ekspertë me diploma universitare në një fushë të caktuar, Komisioni Vlerësues me pëlqimin e ministrit mund të marrë në konsideratë licencimin e kandidatëve që kanë të paktën dhjetë (10) vite përvojë pune pas përfundimit të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës universitare, këta kandidatë duhet të dëshmojnë përvojën e tyre në fushë të caktuar përmes trajnimeve të specializuara ose formave tjera që janë të pranueshme për Komisionin.

3. Përrjashtimisht nën-paragrafit 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni, për specialistët mjekësorë përvoja e punës e kërkuar është një (1) vitë pas përfundimit të provimit specialistik.

4. Për qëllime të verifikimit të përvojes së punës, kandidati duhet të paraqes dëshmi që vërtetojnë përvojën përkatëse të punës.

Neni 11

Kushtet për super-ekspertizë

1. Kandidatët që kanë kualifikim akademik master dhe së paku shtatë (7) vite përvojë pune, ose studime themelore dhe dhjetë (10) vite përvojë pune, mund të kualifikohen për kryerjen e super ekspertizës.

2. Super ekspertiza kryhet nga një institucion publik i specializuar, institucion publik profesional ose nga tre (3) ekspertë të licencuar.

Neni 12

Kushtet për licencim të ekspertëve të personave juridik

1. Personat juridik licencohen si ekspertë nga Ministria e Drejtësisë, nëse i plotësojnë këto kushte:

1.1. të jenë të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovës (ARBK);

1.2. në kuadër të veprimtarisë së tyre, kanë edhe kryerjen e ekspertizës për fushë të caktuar;

1.3. të kenë së paku dy (2) punonjës që i plotësojnë kushtet e parapara për ekspert individual sipas nenit 10 të këtij ligji.

2. Gjatë procesit të aplikimit, personat juridik duhet të dorëzojnë:

2.1. licencat profesionale (nëse kërkohet me legjislacionin përkatës për ushtrimin e veprimtarisë), si dhe

2.2. dokumentacionin individual të punonjëseve që dëshmojnë se të njëjtit i plotësojnë kushtet e parapara për kualifikimin e tyre si ekspertë.

3. Ministri me akt nënligjor mund të ndryshojë ose të përcaktojë kërkesa shtesë për kushtet për licencimin e ekspertëve të personave juridik.

Neni 13

Fushat e ekspertimit

1. Ministria e Drejtësisë (me tej: Ministria) shpall thirrjen publike për licencim të ekspertëve në lëmenjtë si në vijim:

1.1. degët e mjekësisë;

1.2. degët e forenzikes;

1.3. financa dhe kontabilitet, përfshirë kontabilitetin forenzikë dhe çështjet tatimore;

1.4. komunikacioni rrugor;

1.5. vlerësim të pronës së luajtshme;

- 1.6. vlerësim të pronës së paluajtshme;
- 1.7. ndërtimtari;
- 1.8. arkitekturë;
- 1.9. inxhinieri;
- 1.10. siguri në punë;
- 1.11. sistemet e informacionit;
- 1.12. siguri kibernetike;
- 1.13. rrjetet kompjuterike;
- 1.14. telekomunikacion;
- 1.15. konkurrencë e lirë;
- 1.16. prokurim publik;
- 1.17. bujqësi dhe pylltari;
- 1.18. veterinari;
- 1.19. grafologji;
- 1.20. gjeodezi;
- 1.21. minierat;
- 1.22. toksikologjia dhe barnat;
- 1.23. mbrojtjen e mjedisit;
- 1.24. mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; dhe
- 1.25. mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to dhe të drejtave të pronësisë intelektuale.

2. Lista nga paragrafi 1 i këtij neni nuk është shterruese, Ministri i Drejtësisë (me tej: Ministri), në rastet kur është e nevojshme mund të plotësojë me vendim listën me disiplina tjera që nuk janë të përfshira në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 14 **Thirrja për aplikim**

1. Ministria shpallë thirrjen për licencim në gjuhët zyrtare dhe e bën publike në faqen zyrtare të ministrisë, për disiplinat siç përcaktohet në nenin 13 të këtij ligji.
2. Kandidatët mund të aplikojnë për licencim gjatë tërë vitit, kurse Komisioni bën vlerësimin e aplikacioneve së paku dy (2) herë në vit.
3. Kandidatët duhet specifikuar nëse aplikimi i tyre bëhet për licencim si ekspert individual apo si person juridik privat.

Neni 15 **Procedura e aplikimit të kandidatëve**

1. Kandidatët gjatë aplikimit duhet që të dorëzojnë pranë ministrisë:
 - 1.1. aplikacionin zyrtar për licencim që përmban informacionet personale, fushën për të cilën kërkohet të licencohen, deklaratën e tyre se në cilën gjuhë zyrtare dëshirojnë t'i nënshtrohen procesit të licencimit, si dhe deklarinimin e tyre nëse i janë nënshtuar këtij procesi më parë;
 - 1.2. një rezymë profesionale që përmban informacione si shkollimin, njohuritë dhe përvojën profesionale të kandidatit;
 - 1.3. dokumente që dëshmojnë se i plotësojnë kushtet nga neni 10 i këtij ligji;
 - 1.4. pagesën për kandidatët juridik dhe fizik, shuma e së cilës përcaktohet nga ministria.
2. Çdo mungesë e dokumentacionit përbën bazë për diskualifikimin e kandidatit.
3. Ministri me akt nënligjor mund të ndryshojë ose të përcaktojë kërkesa shtesë për procedurën e aplikimit, verifikimit dhe vlerësimit të aplikacioneve të kandidatëve.

Neni 16 **Komisioni Vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për licencim**

1. Ministri me vendim themelon Komisionin Vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për licencim (më tej Komisioni).
2. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë: dy (2) nga të cilët janë zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë, një (1) përfaqësues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e gjyqtarëve, një (1) përfaqësues i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e prokurorëve dhe një (1) përfaqësues i odës përkatëse, sindikatës, apo organizatës vetërregulluese për fushën përkatëse.
3. Në rast se institucionet nuk i përgjigjen ftesës për të qenë anëtarë të Komisionit Vlerësues, ministri me vendim mund t'i zëvendësojë ata me anëtarë jo gjyqtarë ose jo prokurorë.
4. Komisioni është përgjegjës për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, ku verifikon dhe vlerëson përvojën, kualifikimet dhe shkollimin e kandidatëve përmes:
 - 4.1. punimeve shkencore të publikuara;
 - 4.2. opinionëve profesionale të shkruara për gjykata dhe organe tjera profesionale;
 - 4.3. shkrime akademike apo shkencore;
 - 4.4. në rast të dyshimit mund të verifikojë të dhënat përmes kontaktit të personave juridik apo institucioneve ku kandidati ka punuar, gjegjësisht për të cilin person juridik apo institucion ka kryer punë apo ka ofruar shërbime profesionale;
 - 4.5. Komisioni merr në konsideratë edhe kurse apo trajnime profesionale shtesë, në rast kur kemi të bëjmë me disiplina të ndryshme që nuk ofrohen si programe universitare të akredituara në Republikën e Kosovës;
 - 4.6. Komisioni merr në konsideratë edhe licencimet e mëhershme të kandidatëve të kryera në institucione tjera.

5. Komisioni mundet të marrë në konsideratë edhe kualifikime të tjera profesionale që nuk përfshihen në këtë nen.

Neni 17

Vendimi dhe rekomandimi i Komisionit

1. Pas vlerësimit të aplikacioneve, Komisioni bën publik vendimin me listën e personave të kualifikuar të cilët i plotësojnë kushtet e licencimit për ekspert në kryerjen e ekspertizave apo super ekspertizave dhe i rekomandon ministrin licencimin e tyre.

2. Çdo ekspert i kualifikuar në kryerjen e super ekspertizave në një fushë të caktuar mund të ushtrojë edhe rolin e ekspertit në kryerjen e ekspertizave.

3. Licencat për ekspertë gjyqësorë lëshohen për afat pesë (5) vjeçar, me mundësi vazhdimi.

4. Ministri nënshkruan licencën e ekspertit.

5. Licenca nga paragrafi 4 i këtij neni përfshin:

5.1. emrin, mbiemrin dhe numrin e licencës;

5.2. kualifikimin nëse licenca është për ekspert individual apo ekspert të personave juridik;

5.3. kualifikimin nëse eksperti individual apo eksperti i personit juridik kualifikohet edhe për kryerjen e super ekspertizës;

5.4. fushën në të cilën është i licencuar;

5.5. kohëzgjatjen e licencës.

6. Në rast se Komisioni me vendim përcakton se kandidati nuk i plotëson kushtet për licencim, kandidati ka të drejtë ankese.

7. Personat që nuk kualifikohen sipas paragrafit 6 të këtij neni mund të paraqesin ankesë tek ministri, brenda afatit prej shtatë (7) ditësh.

8. Ministri brenda shtatë (7) ditësh vendos në lidhje me ankesën dhe ky vendim është përfundimtar.

Neni 18

Betimi

1. Pas licencimit ekspertët e japin betimin para Ministrit.

2. Teksti i betimit është: Beto hem se punën e ekspertit do ta kryej me ndërgjegje të lartë, në mënyrë të pavarur, të paanshme, me profesionalizëm, si dhe në përputhje me normat ligjore, etike dhe standardet shkencore e profesionale.

3. Në rast se personi fizik apo juridik nuk e plotëson kushtin sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet t'ia dorëzojë ministrit një kërkesë me arsyetim për një datë tjetër për betimin e tij. Ministri vendos në lidhje me kërkesën dhe ky vendim është përfundimtar.

Neni 19 **Kushtet që duhet plotësuar pas dhënies së betimit**

1. Pas dhënies së betimit, subjekti që kryen ekspertizë:
 - 1.1. lidh marrëveshje për sigurimin e dëmit;
 - 1.2. duhet të ketë vulën zyrtare; dhe
 - 1.3. duhet të depozitojë nënshkrimin dhe inicialet e tij në Ministri.
2. Subjekti që kryen ekspertizën është i detyruar që në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dhënia e betimit, t'ia dërgojë Ministrisë dëshmitë se i ka plotësuar kushtet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Subjekti që kryen ekspertizën nuk do të përfshihet në regjistrin e eksperteve nëse:
 - 3.1. refuzon dhënien e betimit;
 - 3.2. pa shkaqe të arsyeshme nuk i përgjigjet thirrjes për dhënien e betimit; dhe
 - 3.3. në afatin e paraparë nga paragrafi 2 i këtij neni nuk i dërgon dëshmitë për plotësimin e kushteve të parapara për përfshirje në regjistër.

Neni 20 **Regjistri i ekspertëve**

1. Ministria krijon një regjistër për ekspertë.
2. Regjistrat bëhen publik në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) si dhe atë të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK).
3. Ky regjistër do të përfshijë:
 - 3.1. ekspertët individual;
 - 3.2. ekspertë që janë përfaqësues të personave juridik;
 - 3.3. institucionet e specializuara;
 - 3.4. institucionet publike profesionale.
4. Ky regjistër do të përmbajë, por që nuk kufizohet në të dhënat si në vijim:
 - 4.1. për ekspert individual: cilësinë e tij si ekspert në kryerjen ekspertizave apo super ekspertizave, emri dhe mbiemri, adresën, numrin e telefonit, emailin, numrin e licencës, fushën e ekspertizës;
 - 4.2. për ekspertin që përfaqëson personin juridik: cilësinë e tij si ekspert në kryerjen ekspertizave apo super ekspertizave, emri dhe mbiemri i ekspertit, emri i biznesit, adresën e biznesit, numri unik i biznesit, numrin e telefonit, mail-in, numrin e licencës, fushën e ekspertizës;
 - 4.3. për institucionet e specializuara dhe institucionet publike profesionale: emrin e institucionit, adresën e institucionit, numrin e telefonit, fushën e ekspertizës, si dhe emrat e personave që kualifikohen si ekspertë.

5. Ministria është përgjegjëse për përditësimin e Regjistrit të ekspertëve dhe njofton pa vonesë Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) pas çdo përditësimi të këtij Regjistri.

6. Ministria mund të nxjerrë akt nënligjor për ndryshimin dhe përmbajtjen e të dhënave në Regjistrin e ekspertëve.

Neni 21 Kartela

Eksperti ka kartelën e tij identifikuese e cila do të rregullohet me akt nënligjor nxjerr nga Ministri.

Neni 22 Vazhdimi i licencës

1. Ministri bën vazhdimin e licencës.
2. Kërkesa për vazhdimin e licencës bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë dhe jo më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë para kalimit të afatit të përcaktuar në vendim.
3. Së bashku me kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni, subjekti që kryen ekspertizën paraqet edhe deklaratën nën betim.

KAPITULLI IV DISIPLINIMI DHE LARGIMI NGA REGJISTRI I EKSPERTEVE

Neni 23 Inicimi i procedurës

1. Ministria mund të filloj procedurë disiplinore ndaj ekspertit në rastet kur ka një kërkesë për të iniciuar procedurën nga institucioni përkatës.
2. Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni parashtrohet me rastin kur pretendohet se subjekti që kryen ekspertizë ka kryer një nga veprimet që përbejnë shkelje sipas dispozitave të këtij ligji.
3. Ministria mund të filloj procedurën disiplinore edhe pas njoftimit që i bën Akademia e Drejtësisë për mos vijimin e trajnimit nga ana e ekspertit sipas nenit 35 të këtij ligji.

Neni 24 Emërimi i komisioneve dhe zhvillimi i procedurës

1. Pas pranimit të kërkesës nga institucioni përkatës, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga pranimi i kërkesës, Ministria merr vendim për fillimin e procedurës disiplinore dhe njofton palën që është subjekt i procedurës disiplinore.
2. Ministria emëron Komisionin Disiplinor i cili përbëhet nga dy (2) përfaqësues të Ministrisë dhe një (1) anëtarë rezervë, me mandat dy (2) vjeçar me mundësi vazhdimi. Anëtari i tretë emërohet ad-hoc nga radhët e ekspertëve të së njëjtës fushë me ekspertin që është subjekt i procedurës disiplinore.
3. Ministri emëron edhe Komisionin për Ankesa, i cili përbëhet nga një (1) përfaqësues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e gjyqtarëve, një (1) përfaqësues i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e prokurorëve, një (1) përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë dhe një (1) anëtarë rezervë, me mandat dy (2) vjeçar me mundësi vazhdimi. Anëtarët nga radhët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës emërohen në Komision të Ankesave

sipas propozimeve të këshillave përkatës.

4. Në rast se institucionet nuk i përgjigjen ftesës për të qenë anëtarë të Komisionit Vlerësues, Ministri me vendim mund t'i zëvendësojë ata me anëtarë jo gjyqtarë ose jo prokurorë.

5. Ministria nxjerr akt nënligjor për rregullimin e procedurës disiplinore.

Neni 25 **Shkeljet disiplinore**

1. Masa disiplinore për revokim të licencës shqiptohet nëse eksperti:

1.1. kryen në mënyrë joprofesionale ose të pandërgjegjshme ekspertizën në kundërshtim me rregullat e shkencës dhe standardet profesionale;

1.2. vepron në kundërshtim me rregullat për normat etike dhe konfliktit të interesit;

1.3 shkel rëndë detyrat e përcaktuara me këtë ligj dhe në këtë mënyrë rrezikon seriozisht besimin në paanshmërinë e tij dhe nëse ndërmerr një veprim për të cilin nuk i është lejuar ta ndërmarrë në pajtim me këtë apo me ligjin tjetër; ose

1.4. shkelë rëndë dhe nuk vepron sipas vendimeve, urdhrave dhe konkluzioneve të institucionit kërkues, përfshirë refuzimin pa arsye për të kryer ekspertizën.

Neni 26 **Masat disiplinore**

1. Komisioni Disiplinor pas dëgjimit të palëve dhe shqyrtimit të rastit merr vendim dhe shqipton masat si në vijim:

1.1. vërejtje publike;

1.2. fshirje e përkohshme nga regjistri në periudhë jo më gjatë se një (1) vit;

1.3. vijim i detyruar i trajnimit; apo

1.4. rekomandim për revokimin e licencës dhe shlyerjen nga regjistri.

2. Për shkelje të rënda, Komisioni mund të pezullojë licencën e ekspertit gjatë zhvillimit të procedurës deri në përfundim të shqyrtimit të masës disiplinore.

3. Me rastin e shqyrtimit të masave disiplinore Komisioni Disiplinor merr parasysh shkallën e ashpërsisë së shkeljes dhe pasojat e saj, shkalla e përgjegjësisë së ekspertit, rrethanat në të cilat është kryer shkelja, sjellja e tij e mëparshme, si dhe rrethanat të tjera.

Neni 27 **Ankesa ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor**

1. Pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor mund të bëjë ankesë pranë Komisionit të Ankesave brenda afatit tridhjetë (30) ditor.

2. Komisioni i Ankesave mund të merr vendim që të:

2.1. udhëzojë Komisionin Disiplinor për të rishqyrtuar edhe një herë rastin;

2.2. vërtetojë vendimin e Komisionit Disiplinor apo ta ndryshoj atë.

3. Vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar, përjashtimisht në rastet kur bëhet rekomandimi tek Ministri për revokim të licencës dhe shlyerjen e ekspertit nga regjistri, në ç'rast vendimi i Ministrit përbën vendim përfundimtar.

Neni 28 Revokimi i licencës

1. Ministri revokon licencën për ekspert me vendim, në rastet si në vijim:

- 1.1. në bazë të rekomandimit për marrjen e licencës si rezultati i procedurës disiplinore;
- 1.2. kur eksperti ka humbur zotësinë e të vepruarit më vendim gjyqësor;
- 1.3. licenca është lëshuar në bazë të të dhënave të pasakta;
- 1.4. kur eksperti dënohet tre (3) herë nga gjykata përkatëse në tre (3) vitet e fundit;
- 1.5. nëse organi përkatës që e ka lëshuar licencën, mbi bazën e të cilit e ushtron profesionin, ia revokon të njëjtën; dhe
- 1.6. është dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale të kryer me dashje, apo vepër penale të kryer nga pakujdesia dhe për të cilën është dënuar deri në një (1) vit burgim efektiv.
- 1.7. të ketë dënim gjyqësor të formës së prerë për ndalim të ushtrimit të profesionit.

2. Revokimi i licencës së personave juridik bëhet në rastet kur eksperti i angazhuar në personin juridik që ofron ekspertizë përmbush ndonjë nga kriteret e parapara me paragrafin 1 të këtij neni dhe ky vendim ndikon në atë që personin juridik të mos përmbush minimumin e numrit të individëve të angazhuar siç kërkohet me nenin 12 të këtij ligji.

3. Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Neni 29 Përfundimi i licencës

1. Subjektit që kryen ekspertizën i përfundon vlefshmëria e licencës në rastet si në vijim:

- 1.1. me vdekjen e ekspertit;
- 1.2. me shuarjen e personit juridik apo mos përmbushjen të kriteve nga neni 12 i këtij ligji; dhe
- 1.3. mosvazhdimi apo ripërtëritja e licencës;
- 1.4. me kërkesë të vet ekspertit.

2. Pasojat juridike të përfundimit të vlefshmërisë së licencës janë të njëjta si me rastin e revokimit të licencës.

Neni 30 Shlyerja nga regjistri

1. Pas vendimit për revokim, pezullim apo përfundim të vlefshmërisë së licencës, Ministria bën shlyerjen e ekspertit nga regjistri dhe udhëzon ekspertin që të ndalojë çfarëdo aktiviteti në të

cilat është i angazhuar si ekspert i licencuar.

2. Pas shlyerjes së ekspertit nga regjistri, Ministria pa vonesë njofton Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës.

3. Institucioni përkatës nuk mund të pranojë asnjë ekspertizë nga eksperti i shlyer, i revokuar, i pezulluar apo që i ka përfunduar vlefshmëria e licences, pavarësisht nëse vendimi për caktim të ekspertit daton para vendimit të ministrit për revokim të licencës.

KAPITULLI V ANGAZHIMI I EKSPERTEVE, TRAJNIMET DHE STANDARDET E MIRËSJELLJES

Neni 31 Caktimi i ekspertit

1. Institucioni përkatës cakton ekspertin vetëm nga regjistri i ekspertëve i publikuar nga Ministria, sipas radhës së angazhimit, qoftë sipas detyrës zyrtare apo në bazë të kërkesës së palëve.

2. Kur njëra nga palët kërkon caktimin e një eksperti tjetër apo kryerjen e super ekspertizës, do të ndiqet e njëjta procedurë e paraparë me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Ekspertizat, e sidomos ato me të ndërlikuara, i besohen institucioneve të specializuara dhe atyre publike profesionale.

4. Eksperti njoftohet me materialet e çështjes përmes dosjes së siguruar nga institucioni përkatës dhe në të njëjtën kohë është i detyruar që:

4.1. të iu përmbahet saktësisht kërkesave të përcaktuara në vendim për caktim të ekspertit;

4.2. të informojë institucionin kërkues urdhërues në rast se ka ndonjë konflikt interesi;

4.3. të paraqitet para institucionit përkatës, sipas kërkesës.

Neni 32 Konflikti i interesit

1. Eksperti njofton institucion përkatës se ka konflikt interesi për të kryer ekspertizë, në qoftë se:

1.1. është vetë palë, përfaqësues i palës, apo në qoftë se me palën ka ndonjë interes financiar;

1.2. me palën ose me përfaqësuesin e saj është në lidhje gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt;

1.3. në qoftë se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo;

1.4. është aksionar apo anëtar i personit juridik që është palë në procedurën e iniciuar me padi; si dhe

1.5. ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Në rast të ekzistimit të rrethanave të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni, eksperti

njofton institucionin përkatës mbi bazën e së cilës institucioni kërkues cakton një ekspert tjetër.

3. Mos lajmërimi i konfliktit të interesit nga ana e ekspertit përbën bazë për të rekomanduar iniciimin e procedurës disiplinore nga ana e institucionit përkatës.

Neni 33 **Fshehtësia e informatave**

1. Informatat e mësuar gjatë kryerjes së ekspertimeve janë të fshehta për opinionin.
2. Zbulimi i informatave të parapara me paragrafin 1 të këtij neni mund të bëhet publike pas urdhrat të lëshuar nga institucionet urdhëruese.
3. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga ekspertët duhet të përdoren në pajtim me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin përkatës për klasifikimin e informacionit.

Neni 34 **Sigurimi i përgjegjësisë**

1. Eksperti është i detyruar të sigurohet nga përgjegjësia për dëmin që mund t'ia shkaktojë gjatë kryerjes së ekspertizës palës ose një pale të tretë në mënyrë të pandërgjegjshme apo si rrjedhojë e neglizhencës së tij apo neglizhencës së personave që punojnë nën përgjegjësinë e tij.
2. Marrëveshja për sigurimin e dëmit lidhet për një periudhë pesë (5) vjeçare dhe shuma minimale për sigurim për të cilën subjekti që kryen ekspertizën duhet doemos të lidhë marrëveshje për sigurim për dëmet të cilat eksperti mund t'iu shkaktojë palëve apo personave të tjerë është njëqind mijë (100.000) euro.
3. Eksperti është i detyruar të ripërtrijë rregullisht sigurimin e përgjegjësisë, mungesa e së cilës mund të jetë bazë për mos caktim si ekspert në procedurë gjyqësore apo administrative.
4. Sigurimi nga përgjegjësia i rregulluar në pajtim me këtë nen nuk e liron ekspertin nga përgjegjësia e tij ndaj të palëve të dëmtuara për dëmin e shkaktuar, në përputhje me ligjin.

Neni 35 **Trajnimet**

1. Ekspertet i nënshtrohen programit të trajnimit përmes Akademisë së Drejtësisë me qëllim të zgjerimit të njohurive dhe aftësive teorike dhe praktike në funksion të kryerja profesional dhe efektiv të ekspertizës.
2. Trajnimi është i detyrueshëm sipas politikave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria në konsultim me institucionet përkatëse si dhe në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë.
3. Mos vijimi i trajnimit nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni do të konsiderohet shkelje disiplinore.

Neni 36 **Kodi i Etikës**

1. Për të përcaktuar rregullat e mirësjelljes dhe etikën për ekspertë, Ministria nxjerr akt nënligjor.
2. Shkelja e aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni përbën bazë për iniciim dhe marrje të masave disiplinore.

KAPITULLI VI KOMPENSIMI

Neni 37 Kompensimi i ekspertëve

1. Për kryerjen e ekspertizës, eksperti ka të drejtë në kompensim dhe rimbursim të shpenzimeve me pagesë për shërbimin e ofruar.
2. Përveç kompensimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, eksperti ka të drejtë në rimbursim të shpenzimeve shtesë të bëra për qëllim udhëtimi apo shpenzime të ngjashme.
3. Tarifat për kryerjen e ekspertizës dhe kompensimin e shpenzimeve të shërbimit përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 38 Kompensimi për shërbimet e ekspertizës nga institucionet e specializuara

1. Ofrimi i shërbimeve të ekspertizës nga institucionet e specializuara nga fushëveprimi i tyre për institucionet kompetente bëhet pa pagesë.
2. Përjashtimisht, në rastet kur institucionet e specializuara nuk e kanë në fushëveprimin e tyre ekspertizën përkatëse, për këto ekspertiza, ekspertët e punësuar në këto institucione mund të angazhohen shtesë sipas kërkesës së institucioneve kompetente në cilësi të ekspertit të fushës së caktuar me kompensim.
3. Për kompensimin e shërbimeve të ofruara nga paragrafi 2 i këtij neni, ekspertit i takojnë dyzet (40) për qind të tarifës përkatëse, të cilat i transferohen direkt nga institucioni urdhëruar.
4. Kur institucioni përkatës urdhëron pjesëmarrjen e ekspertit sipas paragrafit 2 të këtij neni në seancë gjyqësore për dhënien e mendimit plotësues për ekspertizën e kryer, kompensimi i bëhet ekspertit për çdo seancë.
5. Kur institucioni përkatës urdhëron dhënien e mendimit me përfshirjen e më shumë se një eksperti, kompensimi bëhet për secilin veç e veç.
6. Lartësia e shumës për pjesëmarrje në seancë gjyqësore të ekspertit përcaktohet me aktin nënligjor nga paragrafi 3 i nenit 37 të këtij ligji.

Neni 39 Kompensimi i anëtareve të komisioneve

1. Anëtarët e emëruar në komisionet e parapara me dispozitat e këtij ligji, për punën e tyre në komisione, kanë të drejtë kompensimi.
2. Lartësia e kompensimit sipas paragrafit 1 të këtij neni realizohet në bazë të legjislacionit përkatës për pagat në sektorin publik.

KAPITULLI VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 40 Dispozitat kalimtare

1. Ministria fillon procesin e licencimit të ekspertëve jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga hyrja

ne fuqi e këtij ligji dhe do ta përfundojë procesin brenda një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Ministria nxjerr aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, brenda gjashtë (6) muajve prej hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Licencimi i ekspertëve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës i kryer në tre (3) vitet e fundit është i vlefshëm për atë kohë sa nuk skadon afati pesë (5) vjeçar i licencës së paraparë me këtë ligj. Ekspertët e licencuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të dorëzojnë pranë Ministrisë Sigurimit e Dëmit siç parashihet me nenin 19 të këtij ligji.

4. Në afat prej tre (3) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ia dorëzon Ministrisë tërë dokumentacionin dhe listën e ekspertëve të licencuar sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 41 Epërsia e ligjit

Në rast të mospërputhjes së dispozitave ligjore, ky ligj ka epërsi juridike ndaj çdo akti tjetër ligjor apo nënligjor që përmban dispozita për licencimin e ekspertëve gjyqësorë.

Neni 42 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-191
13 korrik 2023**

Shpallur me dekretin Nr. DL-139/2023, datë 01.08.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu